



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dostiguar Received / Delivered	11.08.2022	viti year	2022
Organ / Shënia Organ / Jednica Org / Unit	Dr. Prot. R. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kohëzina Quantity
SHKIPARIA	4660/2022		1/1



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.581/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca- anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.307/2022 të datës 29.03.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 10.08.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa A.nr.581/2022 e datës 29.06.2022 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, sipas plotësim ndryshimit të akt emërimit me numër të protkollit 1220 , të datës 28.04.2014 në pozitën "Zyrtar i Inspektoriatit Farmaceutik për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Me datën 02.06.2022, Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, ka nxjerrë Vendimin Nr.Prot.05-2606, sipas të cilit e ka refuzuar kërkesën e ankuesit me nr.prot.05-928 të datës 28.02.2022, pas pranimit të Vendimit A.nr.307/2022 të datës 24.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me detyrimin e nxjerrjes së aktit administrativ konform kërkesës së ankuesit.

I pakënaqur me Vendimin Nr.Prot.05-2606, e datës 02.06.2022 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm, me datën 29.06.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 3788/2022 në Këshillin e

Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të cenimit drejtave të nëpunësve civil të garantuar me kreun e VI të Ligjit nr.03/L-149 për SHCRK.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 06.04.2022, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1920/2022 për përgjigje në ankesë tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa me datën 14.04.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga ky institucion së bashku me provat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1665/2022 të datës 29.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 25.02.2022 për tek Ministria e Shëndetësisë; Kërkesën e ankuesit të datës 25.09.2018, në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë për nivelizim të pagës; Ankesën e ankuesit të datës 14.10.2015 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; Kërkesën e ankuesit të datës 14.02.2018 për nivelizim të pagës; Ankesën-Kërkesën e ankuesit të datës 05.12.2017 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; E-mailin zyrtar të datës 04.12.2017; Kërkesën e ankuesit për nivelizim të pagës të datës 21.11.2017 ; Kërkesën për mos dëmtimin e të ardhurave të IFPMM-së të datës 07.09.2015; E-mailin zyrtar të datës 20.11.2017; Kërkesën e datës 21.11.2017 për nivelizim nga ankuesi për Udhëheqësin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë; Vendimin me numër 05-1373 të datës 13.03.2015 nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin me numër 05-6418 të 10.11.2014 nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë; Kërkesën për nivelizim të pagës të datës 14.02.2018 nga ankuesi për tek Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë; E-mailin zyrtar të datës 04.12.2017; Ndryshim plotësimin e akt emërimit të ankuesit me numër 1220 të datës 28.04.2014 së bashku me përshkrimin e detyrave të punës të datës 25.04.2014; Vendimin me numër 535/1 të datës 14.03.2014 nga Kryeshefi Ekzekutiv i AKPM-së; Vendimin me numër 535 të datës 26.02.2014 lidhur me emërimin e komisionit përzgjedhës për pozitën zyrtar i inspektoratit farmaceutik; Akt emërimit të ankuesit me numër 161 të datës 06.02.2012; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.04.2022 nga Ministria e Shëndetësisë me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën e ankuesit të datës 14.10.2015 në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Ministrisë së Shëndetësisë; Shkresën zyrtare të datës 05.11.2018 me numër 05-7384/2 lidhur me dokumentacionin sipas kërkesës nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë; Ankesën e ankuesit të datës 26.10.2018 për në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 06.04.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 14.04.2022 nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Ankesën-kërkesën e ankuesit të datës 05.12.2018 me numër 05-8908 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Formularin e bordit për licencim të institucioneve të kujdesit primar shëndetësor; Shkresën zyrtare me numër 05-7384/2 te datës 05.11.2018 nga Ministria e Shëndetësisë për Këshillin; Kërkesën për prova shtesë të datës 10.05.2022 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për Ministrinë e Shëndetësisë; Përgjigjen në kërkesë të datës 12.05.2022 nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me provat shtesë për Këshillin; Listat e pagave për muajin qershor dhe korrik të viti 2015, muajin tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2021 si dhe janar, mars dhe shkurt të vitit 2022 nga Ministria e Shëndetësisë; Vendimin Nr.Prot.05-2606, e datës 02.06.2022 nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm; Vendimin A.nr.307/2022 të datës 24.05.2022 nga Këshilli i Pavarur



Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 29.06.2022 me numër të protokollit 3788/2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën e datës 21.07.2022 përmes e-mailit zyrtar lidhur me provat shtesë nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen e datës 21.07.2022 përmes e-mailit zyrtar lidhur me provat shtesë nga Ministria e Shëndetësisë; Listën e pagave për muajin maj të vitit 2015 për nëpunësit e Inspektoratit shëndetësor të AKPM-së; Listën e pagave për muajin korrik të vitit 2022 për nëpunësit e Inspektoratit shëndetësor në Ministrinë e Shëndetësisë; Akt emërimin 01Nr.Prot.2439 të datës 31.12.2012 dhe Akt emërimin 06Nr.Prot.624 të datës 30.04.2012 për nëpunësen R.Th; Akt emërimin 06Nr.Prot.626 të datës 02.05.2012 për nëpunësin R.M; Akt emërimin 06Nr.Prot.623 të datës 30.04.2012 për nëpunësin B.R; Akt emërimin 01Nr.Prot.2512 të datës 31.10.2013 për nëpunësen Q.H; Akt emërimin 01Nr.Prot.2514 të datës 31.10.2013 për nëpunësen F.E

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se është e pabazuar ankesa e parashtruar nga ankuesi

sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht dispozitat e nenit 19, ku përcaktohet se: *“Zyrtari publik ka të drejtë në pagë dhe shpërblim për punën e kryer si dhe shtesa të përcaktuara me Ligjin e pagave”*, ka konstatuar se ankuesi ka punuar në kuadër të Inspektoratit Farmaceutik të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në pozitën si *“Asistent i licencimit”*, sipas Akt emërimit Nr.Prot.161 të datës 06.02.2012, ku përgjatë periudhës sa ka punuar në këtë institucion ka gëzuar shtesën në vlerën prej 30% të pagës bazë bashkë me kolegët e inspektoratit farmaceutik, mirëpo që pas kalimit të Inspektoratit Farmaceutik të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në kuadër të Inspektoratit Shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë sipas Vendimit Nr.83/14 të datës 07.11.2014 nga Ministri i Ministrisë së Shëndetësisë, as ankuesi e as kolegët e tij nuk kanë pranuar shtesën në vlerën prej 30% të pagës bazë, bazuar në përgjigjen në kërkesë të datës 21.07.2022 dhënë nga Udhëheqësi i Burimeve Njerëzore për Këshillin, i cili ndër të tjera ka deklaruar se *“ Ndërsa sa i përket shtesës prej 30% të pagës MEF nuk ka pranuar që kjo shtesë të bartet, sepse shtesa prej 30% e pagës është e miratuar vetëm për stafin e AKPPM-së”*.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar po ashtu edhe listën e pagave e dërguar nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe pas shikimit të vijueshmërisë për muajt tetor, nëntor dhe dhjetor të vitit 2021 dhe muajt janar, shkurt dhe mars të vitit 2022, ka konstatuar se i gjithë stafi i inspektoratit farmaceutik në kuadër të inspektoratit shëndetësor të kësaj ministrie, kanë pranuar vetëm pagat sipas koeficientëve që mbajnë, mirëpo jo edhe shtesën mbi pagën bazë në vlerën prej 30%, andaj edhe pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me atë se i njëjti është i diskriminuar nga kolegët tjerë të cilët e realizojnë këtë shtesë është i pa bazuar dhe i pa qëndrueshëm.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ndërlidhur me këtë fakt po ashtu ka analizuar edhe Vendimin Nr.Prot.05-6417/3 të datës 13.12.2018 i nxjerrë nga Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Ministrinë e Shëndetësisë, ku po ashtu edhe në arsyetim të këtij vendimi thuhet se *“personeli i inspektoratit shëndetësor nuk përfiton shtesën prej 30% në paga”*, e nga ku rezulton se as ankuesi si pjesë e këtij inspektorati nuk e përfiton këtë shtesë.

Ndërlidhur me ankesën e ankuesit si dhe për të qartësuar situatën juridike lidhur me realizimin e shtesës në pagë, Kryesuesi i kolegjit për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil së bashku me Zyrtares e lartë për bashkëpunim profesional, me datën 08.08.2022 kanë realizuar vizitën në Ministrinë e Shëndetësisë ku në prezencë të Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore të kësaj ministrie, pas shikimit dhe verifikimit të dokumentacionit lidhur me realizimin ose jo të shtesës prej 30% mbi pagën bazë nga ana e nëpunësve të Inspektoratit Shëndetësor të kësaj ministrie, është vërtetuar fakti se këtë shtesë e kanë realizuar nëpunësit shëndetësor të cilët kanë qenë në kuadër të Agjencisë së Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale, shtesë të cilën e ka gëzuar edhe ankuesi sa ka qenë pjesë e stafit të kësaj agjencie, ndërsa pas kalimit të inspektoratit shëndetësor nga Agjencia e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në kuadër të inspektoratit shëndetësor të Ministrisë së Shëndetësisë, këtë shtesë nuk e gëzon asnjë nëpunës në kuadër të inspektoratit shëndetësor të kësaj ministrie, përveç pagës që gëzojnë sipas pozitive dhe koeficientëve që kanë pasur si staf shëndetësor në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale në bazë të kodit të cilin e kanë pasur janë bartur edhe tek Ministria e Shëndetësisë, ndërsa ankuesi ka mbajtur dhe mban pozitën si nëpunës civil dhe realisht pas kalimit në Ministrinë e Shëndetësisë ankuesi ka pranuar vetëm pagën pa shtesën në pagën bazë prej 30%, të cilën e ka marrë si staf edhe në Agjencinë e Kosovës për Produkte dhe Pajisje Medicinale sa ka punuar.

Pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda, A.nr.581/2022, datë 10.08.2022

Ardita Perçuku-Shyti

Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- ❖ Ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.